



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Histori e Mesjetës e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 45 orë mësimore; 30 leksione / 15 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva e përgjithshme lëndore: Studentët duhet të dëshmojnë në fund të kursit, se dinë të individualizojnë e të kuptojnë nyjet themelore të problemeve të trajtuara si dhe përdorimin që u bëhet këtyre mësimëve të historisë, në mënyrë që të mos jenë të kushtëzuar ideologjikisht. Duhet të përdorin me saktësi termat e ligjërimit specialistik të disiplinës në fjalë. Zhvillimi i kompetencës së arsyetimit, radhitjes logjike të njohurive, selektimit të ngjarjeve më të rëndësishme të një historie komplekse njëmijëvjeçare.

Objektiva specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Aftësohet në përdorimin e saktë të literaturës studimore, burimore tekstuale të bibliografisë së rekomanduar.
2. Të kuptojë çelësin e leximit të historisë njerëzore.
3. Aftësohet në lidhjen e logjikshme interdisiplinore të lëmisë së shkencave humanistike.
4. Të përdorë saktë referencat bibliografike

Rezultate të pritshme:

1. Aftësia për të sintetizuar, përmbledhur, krahasuar, deduktuar, në mënyrë autonome.
2. Aftësia për të përpunuar literaturën shkencore me qëllim që të jenë në gjendje të koordinojnë njohuritë e përfuara.
3. Të vërë në përdorim instrumentet e sintezës dhe deduktimit.
4. Aftësia për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet, bibliografinë, sitografinë.